

# LETËR PËR HAPJEN E SHKOLLËS

*Letër për prindërit dhe nxënësit që ndikohen nga mbyllja, shkrija dhe zhvendosja e shkollave, në përgatitjen e tyre për ditën e pare të shkollës*



## Shkolla “Bartram” zgjeron opsionin CTE për nxënësit

Drejtorja Arsimore filloi në Qershor punën për zgjerimin dhe shtrirjen e Edukimit Profesional (CTE) në Vjeshtë, për nxënësit e shkollës së Mesme Bartram.

Drejtorja Arsimore do të rinovojë plotësisht 12 klasa për të zhvilluar dy programe të reja CTE, të cilat janë zhvilluar më përpara në shkollën e mesme “Communications Technology High School”.

Rinovimi do të përfshijë përmirësime elektrike, lysterje të klasave dhe instalim të të paisjeve. Klasat për secilin program CTE do të vendosen në seksione të ndara të ndërtesës së shkollës, me qëllim që të krijohet një komunitet mësimesor i përqëndruar.

Në vazhdim të programeve të Teknologjisë të Shëndetit (HRT) dhe Teknologjisë Informative (IT), që ofrohen aktualisht në shkollën “Bartram”, nxënësit do të kenë këtë vjeshtë edhe programet e mëposhteme profesionale CTE:

**Arti Komerical dhe i Reklamave-** Një program mësimesor në artet pamore të aplikuara, që përgatit individët të përdorin teknikat artistike për transmetimin efektiv të ideve dhe informacioneve tek bizneset dhe audiencën, nëpërmjet ilustrimeve dhe formave të tjera të medias së shkruar. Ky program përfshin mësim në konceptet e dizajnit, skicimit, lidhjeve dhe të teknikave si gdhendja, gravura, litografia, ofseti, vizatimi, dhe punimet me karton, piktura, kolazhi dhe grafika kompjuterike.

**Kinematografia & Prodhimi i Filmit/Video-** Një program mësimesor që përgatit individët për transmetimin e informacionit, ideve, gjendjes shpirtërore dhe ndjenjave, përmes prodhimit të filmave dhe videove. Ky program përfshin mësim në teorinë, teknologjinë dhe mjetet që përdoren, prodhimin, drejtimin dhe shpërndarjen e filmit, arteve kinematografike, zërit të filmit, teknikave që përdoren për lloje specifike të filmave dhe/ose videove, teknologji mediatike, krijimit të imazheve në kompjuter, produkteve multimediatike dhe planifikimit e menaxhimit të veprimtarive të filmit/videos.

Puna është parashikuar të përfundojë në mes të muajit Gusht. Para fillimit të shkollës në Shtator “Bartram” do të presë prindërit dhe nxënësit për programet e reja dhe një tur në ndërtesë.

Për më tepër informacion rreth Programeve Profesionale të Drejtorisë Arsimore, ju lutemi vizitoni [www.philasd.org/offices/cte](http://www.philasd.org/offices/cte).



### Si po punojmë?

Një pamje e progresit të Drejtorisë në përgatitjen e shkollave pritëse për vitin e ri shkollor:

#### Përqindja e...

Shkollave pritëse ku ka përfunduar rikonstruksioni i mjediseve	61%
--	-----

Shkollave pritëse ku është konfirmuar drejtori për vitin e ardhshëm shkollor	98%
--	-----

#### Numri i...

Shkollave pritëse që do të marrin fonde për “Positive Behavioral Interventions and Supports” (PBIS) ose “Restorative Practices”	20
---	----



## Programet verore synojnë që t'u mësojnë nxënësve historinë e Filadelfias

Nxënësit e Tetëvjeçareve nga shkollat "Penn Treaty, Moffet, Webster, Hackett, Sheridan West dhe Richmond" janë pjesëmarrës gjatë kësaj vere në një program mësimor të veçantë për pasurimin e dijeve.

Programi "The Penn Treaty Summer Enrichment Program" përdor leksionet e alternuara dhe mbi bazën e projekteve sipas linjës të standardeve shtetërore të Pensilvanisë, për mësimin e historisë së Filadelfias në mënyrë konkrete.

Nxënësit pjesëmarrës do të mësojnë pikat kyçe dhe personalitetet e shquara të Filadelfias dhe do të vizitojnë vendet historike të mësuara në shkollë. Më poshtë është plani i programit:

- ☞ Java e parë: nxënësit do të mësojnë rreth William Penn, dhe do të vizitojnë "Pennsbury Manor".
- ☞ Java e dytë: nxënësit do të mësojnë rreth "Liberty Bell, Betsy Ross, Independence Hall, dhe Franklin Mint", dhe do të bëjnë vizitë me guidë në secilën prej tyre.
- ☞ Java e tretë: nxënësit do të mësojnë për muzikën, artin e kulturën e Filadelfias, do të bëjnë një tur me autobus për pamjet murale në "South Street dhe Ben Franklin Parkway", si dhe vizitë në Muzeumin e Arteve.
- ☞ Java e katërt: nxënësit do të mësojnë rreth Ben Franklin dhe ushqimeve të famshme të Filadelfias. Nxënësit do të vizitojnë "Franklin Square" për një "Taste of Philadelphia", ku do të provojnë ushqime si "cheesesteaks, Tastykakes, dhe pretzels".

Programi financohet plotësisht nga Granti "Penn Treaty's School Improvement" dhe është falas për nxënësit.



Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Filadelfias



## Ribashkimi i Familjes dhe Edukimit

Zyra e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit "FACE"-Albanian

E premte, 9 gusht, 2013  
9am - 3pm  
School of the Future  
4021 Parkside Avenue

## Eventi Vjetor "Përsëri në Shkollë"

çanta Shkollore dhe Dhurata Falas  
Seminare Edukative  
Pavioni i Kolegjit, me Bazë Fetare dhe i Fëmijëve  
Zbavitje, Ushqim, Kënaqësi dhe shumë më  
tepër.....

Albanian



### Takimi i Parë Vjetor i Sigurisë

**Kur:**  
17-19 Korrik  
9 a.m. - 12 p.m.

**Kush:** Mësuesit, këshilltarët, oficerët e policisë, psikologët, dhe i gjithë personeli i shkollës

**Ku:**  
Arts Academy në Benjamin Rush  
(11081 Knights Road)

**Arsyeja:** Qëllimi i Takimit të Sigurisë është të ofrojë për personelin e shkollës mundësinë që të mësojnë për krijimin dhe mbajtjen e një mjedisi të sigurtë mësimor për nxënësit. Sesionet do të drejtohen nga ekspertë që trajtojnë çështje të qëndrimeve kundër vandalizmit, rrugaçerisë, trajtimit të traumave, çështjeve të shëndetit etj. Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Stacy Kerentzis në numrin 215-400-6939.